



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 601 Prot.

Tiranë, më 16/07 / 2014

Lënda : Dërgohen komente lidhur me projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar”.

Drejtuar : Znj. Albana VOKSHI
Kryetare e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.
KUVENDI I SHQIPËRISË

E nderuar Kryetare !

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pasi u njoh me projekt-ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar”, dëshiron të sjellë në vëmendje të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, disa komente dhe sugjerime mbi këtë projekt-ligj:

1. Do të vlerësonim si pozitiv faktin që projekt-ligji i jep prioritet kategorive vulnerabël, si gratë, pasardhësit e mitur, të sëmurët rëndë etj, por në tërësi ky projekt-ligj nuk rrit mundësinë e përshpejtimit të procesit në vetvete, por vetëm rendit kategoritë sipas prioritetit.
2. Në nenin 1, të projek-ligjit, i cili bën ndryshime në nenin 12 të ligjit, duhet patur kujdes në aspektin e teknikës legjislativë. Termat e përdorur duhet të jenë të qartë dhe dispozitat të mos lenë mundësi për të abuzuar gjatë zbatimit.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
wëeb: www.kmd.al

